



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 170/01-15759 dt. 29/04/ 2025



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 3, pika 3.5 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.04.2025, miratoi këtë

V E N D I M

Për shpalljen e z. Javier Solana, “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Vendim të Kuvendit të Komunës miratohet shpallja e z. Javier Solana “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” për z. Javier Solana i jepet për kontributin e tij në përkrahje të Kosovës dhe popullit të saj nëpër proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4


Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Bekim Lestrani

ARSYETIM

Biografi e shkurtër

Havier Solana u lind më 14 Qershor 1942 në Madrid, është politikan me përmasa evropiane nga Spanja.

Pjesë e Partisë Socialiste nga viti 1964, është i diplomuar në Fizikë dhe është një nga diplomatët më të njohur spanjollë. Ka qenë ministër në të gjitha qeveritë spanjolle nga viti 1982 deri në 1995. U emërua sekretar i NATO-s në vitin 1995 deri në 1999, ku pati angazhim të drejtpërdrejtë me luftën e Kosovës.

Z. Solana gjatë bombardimeve të caqeve ushtarake serbe, dëshmoi konsistencë dhe qëndrueshmëri në misionin dhe vizionin e NATO-s për lirinë e Kosovës.

Nga viti 1999 deri në 2009 ka qenë përfaqësues i lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë e Përbashkët të Bashkimit Evropian.

Ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të Kosovës i është drejtuar popullit të Kosovës me një mesazh.


Në mesazhin e tij, Solana thotë “se e mban në zemër popullin e Kosovës”.

Ai tha se Kosova duhet të shndërrohet në një shtet të fortë.

“Duhet të jeni të aftë për të ruajtur demokracinë, të aftë ta ruani lirinë dhe të gatshëm të përgatiteni për ndryshimin e madh, që do të jetë integrimi evropian”, tha ai në mesazhin e tij për popullin e Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 07.05.2025
Zyrtarët përgjegjës:	Erbllin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor	VI-020-254
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj, Zytare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Kuvendit të Komunës së Glllogocit, vlerëson se:

- Vendimi 02 Nr. 170/01-15759 për shpalljen e z. Javier Solana "Qytetar Nderi" i Komunës së Glllogocit, i miratuar në Kuvendin e Komunës me datë 29.04.2025, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.